



Keshilli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr 18009 Prot.

Lezhë, më, 17.10.2021

PROJEKT - VENDIM
Nr. _____, Datë 17.10.2021

PËR
FALJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA PËR KATEGORITË E
TAKSAPAGUESVE “FAMILJARË”, “BIZNES” DHE “INSTITUCIONE,
PËR ZËRIN “TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika1/1.3, germa “b”, neni 35, pika 4 dhe 5, neni 54, germa “f”, Ligjin nr.9632 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Neni 5, germa “c”, neni 35, pika 2, Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit;

V E N D O S I

1. Të përfitojnë lehtësi fiskale duke falur dhe zbritur detyrimet për zërin e “**Tarifës së Shërbimeve Publike**” për të gjithë kategoritë e taksapaguesve “**Familjarë**”, “**Biznes**” dhe “**Institucione**” në rastet, si më poshtë :
 - a. Të falen të gjithë detyrimet e prapambetura përpara vitit 2021, për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Familjarë**”, të cilët kanë detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifatat vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet e prapambetura, për zërin e taksës mbi pasurinë për periudhën e kaluar dhe detyrimet e vitit korent, përfshirë këtu edhe zërin e tarifës së shërbimeve publike, brenda vitit 2021.
 - b. Të bëhet zbritje me 50(pesëdhjetë) %, e të gjithë vlerës së detyrimeve për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Familjarë**”, të cilët **nuk kanë** detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifatat vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet vjetore për vitin korent, brenda vitit 2021.
 - c. Të falen të gjithë detyrimet e prapambetura përpara vitit 2021 për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Biznes**”, të cilët kanë detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifatat vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet e prapambetura për zërat e tjerë të taksave dhe tarifave vendore, për periudhën e kaluar dhe detyrimet e vitit korent, përfshirë këtu edhe zërin e tarifës së shërbimeve publike, brenda vitit 2021.
 - d. Të bëhet zbritje me 50(pesëdhjetë) %, e të gjithë vlerës së detyrimeve për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Biznes**”, të cilët **nuk kanë** detyrime të prapambetura të palikujduara, për taksat dhe tarifatat vendore, vetëm në rastet kur ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet vjetore, për zërat e tjerë të taksave dhe tarifave vendore, brenda vitit 2021.

- e. Të falen të gjithë detyrimet e prapambetura përpara vitit 2021, për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike, për të gjithë taksapaguesit, që bëjnë pjesë në kategorinë e taksapaguesve “**Institucione**”, të cilët kanë detyrime të prapambetura të palikujduara, për tarifatat vendore, nëse ato kryejnë pagesën për të gjithë detyrimet e detyrimet e vitit korrent për zërin e tarifës së shërbimeve publike, brenda vitit 2021.
- f. Në faljet dhe përfitimet e sipërcituara përfshihen edhe kamat vonesat, vetëm për zërin e tarifës së shërbimeve publike.
2. Të gjithë kategoritë e taksapaguesve, të cilët nuk kryejnë pagesën për detyrimet, konform dhe brenda afateve, të cituar në pikën 1 të këtij vendimi, detyrimet e tyre për zërin “Tarifa e shërbimeve publike”, ngelin në fuqi konform VKB nr.46, datë 13.11.2019.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI
PJERIN NDREU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr 18009/1 Prot.

Lezhë, më, 18.10.2021

Relacion

Për

**Faljen dhe Zbritjen e detyrimeve të prapambetura për kategoritë
e taksapaguesve Familjarë, Biznes dhe Institucione,
për zërin e Tarifës së Shërbimeve Publike**

Të nderuar Z.Këshilltarë,

Nisma që Bashkia Lezhë ka ndërmarrë për fshirjen dhe zbritjen e detyrimeve për zërin e tarifës së shërbimeve publike është në vazhden e premtimeve tona të mbajtura, pasi gjithmonë si prioritet kryesor në fushën e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, kemi patur lehtësirat fiskale ndaj të gjithë kategorive të taksapaguesve të Bashkisë Lezhë, me kushtin e zgjerimit sa më shumë të bazës së tatueshme, rritjes në maksimum të pagesës në kohë të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore dhe paralelisht me këto rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, që taksapaguesit përfitojnë.

Shërbimet publike, që ofron sot Bashkia Lezhë, kanë arritur në nivelin, që ne kemi pasur si objektiv që në ditët e para të qeverisjes tonë, por rritja e cilësisë së shërbimeve ka ecur paralelisht edhe me rritjen e kostos së kryerjes së këtij shërbimi. Parë në këtë këndvështrim, në periudhën në vijim ne do shikojmë mundësinë e ngushtimit të diferencës mes kostos së shërbimeve dhe të ardhurave, që vijnë si rezultat i aplikimit të tarifave për shërbimet publike nga të gjithë kategoritë e taksapaguesve familjarë, biznes dhe institucione.

Me qëllim rritjen e nivelit të të ardhurave, në këtë projekt vendim parashikohet kryesisht ulja e borxheve dhe vjelja e detyrimeve të prapambetura dhe ato në kohë reale për të gjithë zërat e taksave dhe kryesisht për zërin e taksës mbi pasurinë, pasi burimi kryesor i të ardhurave është taksa mbi pasurinë, e cila pamvarësisht rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me periudhën e vitit të kaluar, përsëri akoma nuk është në maksimumin e mundshëm të kapaciteteve fiskale të taksapaguesve. Kjo është vendosur si kusht kryesor për kategorinë e taksapaguesve familjarë dhe biznes, të cilët do të përfitojnë faljen e të gjithë detyrimeve të prapambetura për zërin e tarifës së shërbimeve publike, vetëm në rastet kur ato do të shlyejnë detyrimet për taksat mbi pasurinë brenda vitit kalendarik 2021.

Ne kemi bërë pjesë të përfituesve të këtyre lehtësive fiskale, jo vetëm atë kategori, që respekton kushtet e sipërcituara, por edhe atë kategori e cila është treguar korrekte me shlyerjen në kohë konform ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe VKB